



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
*Kuvendi - Skupština - Assembly*

---

**LEGJISLATURA VI**

**Sesioni pranveror**

Komisioni për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrjen e Forcës së Sigurisë së Kosovës  
Mbledhja nr. 15

Prishtinë, më 29.03. 2018, në orën 11:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-204

**PROCESVERBAL**

**Në mbledhje morën pjesë:** Haxhi Shala, kryetar, Rexhep Selimi, zëvendëskryetar i parë, Zoran Mojsilović, zëvendëskryetar i dytë, Ismet Beqiri, Fatmir Xhelili, Xhelal Sveçla, Muharrem Nitaj, Fadil Beka dhe Bahrim Shabani, anëtarë.

**Munguan:** Drita Millaku, Ramiz Kelmendi

**Deputetët të tjerë, pjesëmarrës në takim:** Shemsi Syla

**Nga stafi mbështetës i komisionit:** Nur Çeku dhe Zarë Aliu.

**Mbledhjen e kryesoi,** Haxhi Shala, kryetar i komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky

Rend i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e komisionit e mbajtura me datë 23.03.2018;
3. Shqyrtimi i raportit me amendamente për Projektligjin Nr.06/L-026 për Azil;

4. Shqyrtimi i raportit me amendamente për Projektligji nr. 06/L-036 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.04/L-219 për të Huajt;
5. Të ndryshme.

**Kryetari i komisionit** konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen.

1. Miratimi i rendit të ditës.

*Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.*

2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e komisionit e mbajtura me datë 23.03.2018.

*Procesverbali u miratua pa vërejtje*

3. Shqyrtimi i raportit me amendamente për Projektligjin Nr.06/L-026 për Azil.

**Kryetari**, fillimisht theksoi se këto dy projektligje që janë në rend të ditës, janë ligje q janë pjesë e Agjendës Evropiane për reformë( ERA) dhe të cilat duhet të procedohen sa më shpejt. Gjithashtu theksoi se edhe komisionet e përhershme, kanë dërguar opinionet e tyre për të dy projektligjet.

**Fatmir Xhelili**, lidhur me projektligjin për Azil, theksoi se janë përmendur në disa raste fjalët “pasuri e patundshme”, pasi në legjislacionin e Kosovës nuk është kjo terminologji por i referohemi si pasuri e paluajtshme dhe pasuri e luajtshme, propozoi që të bëhet edhe ky plotësim në projektligjin, që të jetë në përputhje me standardin e hartimit të legjislacionit.

*Komisioni për punë të Brendshme, Siguri dhe mbikëqyrje të FSK-së, në këtë pikë të rendit të ditës me tetë(8) vota për dhe një(1) abstenim( Zora Mojsiloviq) nxori këtë:*

#### **REKOMANDIM**

*Raporti me amendamente për Projektligjin Nr.06/L-026 për Azil procedohet për lexim të dytë në seancë plenare me amendamentet e propozuara dhe propozimin e z.Fatmir Xhelili.*

4. Shqyrtimi i raportit me amendamente për Projektligji nr. 06/L-036 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.04/L-219 për të Huajt.

**Kryetari**, vlerësoi se edhe për këtë projektligj kanë përfunduar të gjitha procedurat dhe hodhi në votim.

*Komisioni për punë të Brendshme, Siguri dhe mbikëqyrje të FSK-së, në këtë pikë të rendit të ditës me tetë(8) vota për dhe një(1) abstenim( Zora Mojsiloviq) nxori këtë:*

#### **REKOMANDIM**

*Raporti me amendamente për Projektligjin nr. 06/L-036 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.04/L-219 për të Huajt.*

### **5. Të ndryshme.**

Kryetari, fjalën ia kaloi z.Rexhep Selimi për të raportuar lidhur me procesin e mbikëqyrjes së Ligjit për Inspektoratin Policor të Kosovës dhe pjesëmarrjen në grupin punues lidhur me procesin e anëtarësimit të Kosovës në INTERPOL, i formuar nga Ministria e Punëve të Brendshme.

**Rexhep Selimi**, lidhur me procesin e mbikëqyrjes së Ligjit të IPK-së, theksoi se janë në proces e sipër dhe është duke u zhvilluar një punë me objektivitet. Tutje theksoi se janë zhvilluar një sërë vizitash dhe janë pritur në Kuvend disa protagonist. Ndërsa sa i përket anëtarësimit të Kosovës në INTERPOL, theksoi se është anëtar i grupit punues në kuadër të Ministrisë së Punëve të Brendshme, që përcjell zhvillimet për procesin e anëtarësimit. Gjithashtu theksoi se zyrtarisht është njoftuar që në takimin e Komitetit Ekzekutiv që organizon takim para mbledhjes së Asamblesë së Përgjithshme të INTERPOL-it, Kosova është vendosur në draft agjendën në mënyrë që të shqyrtohet kërkesa për anëtarësimin e Kosovës, duke shpresuar që gjatë vjeshtës të bëhet anëtarësimi.

**Zoran Mojsiloviq**, të nderuar kolegë, lidhur me ngjarjen e ndodhur kur është arrestuar z.Gjurigj, si person që ka qenë në vend të ngjarjes, ka ndodhur që nga pjesëtarët e Ministrisë së Punëve të Brendshme, ka ndodhur dhunë e pa nevojshme dhe e pa pranueshme, ku ka ardhur deri te lëndimi i përfaqësuesit të Qeverisë. Nuk e di në bazë të çka kanë marrë këtë veprim dhe kanë përdorur forcën dhe me çka do të arsyetojnë lëndimet e shkaktuara, deputetëve, ministrave dhe përfaqësuesve. Tutje theksoi se mendon që kjo ngjarje është për çdo gjykim, që ata që e kanë udhëhequr këtë aksion duhet të marri përgjegjësi për rastin e kryer. Nëse dikush mendon që ndonjë deputet ose ministër ka përdorur forcë, ata duhet që me ndonjë hetim të vërtetojnë. Po ashtu theksoi se janë incizimet e të gjithë aksionit dhe qartë shihet se çfarë ka ndodhur. I gjithë procesi i integritetit të qytetarëve serb në veri të Mitrovicës, ka qenë takimi se si të bëhet integriteti i qytetarëve në vend. Tubimi ka qenë i qetë dhe nëse zyrtarët policor kanë kërkuar ndonjë person që ka bërë ndonjë kundërvajtje, është dashur të sillen ndryshe. Pasi në këtë aksion, kanë filluar ti rrahin deputetët, përfaqësuesit dhe ministrat, duke e sjellë vendin në situatën politike që është. Duke qenë edhe anëtar i Komisionit për Siguri, nuk e përkrah këtë aksion ku zyrtar të lartë janë tërhequr zvarrë, duke shtuar që pasi janë pjesë e Qeverisë dhe me veprime të tilla të sjellin situatën politike në këtë nivel

**Kryetari**, theksoi se edhe Komisioni nuk ka ndonjë raport zyrtar, për të thënë nëse ka pasur shkelje apo nuk ka pasur në rastin e arrestimit të Marko Gjuriq.

**Ismet Beqiri**, theksoi e për aq sa është parë në aksionin e arrestimit të Marko Gjuriq, theksoi se do të ishte mirë të kishte një raport, por konsideroi që do të ishte mirë të shmangemi nga

vlerësimet etnike. Gjithashtu theksoi se çdo qytetar i huaj që viziton shtetin Kosovës, duhet të respektoj procedurat e parapara me ligj, duke theksuar që është e nevojshme që të bëhet integrimi i qytetarëve serb sipas ligjeve të Kosovës. Pasi takimi i organizuar që ishte ftuar z.Gjuriq ka nxitur një lloj reagimi nga ana e institucioneve të Kosovës, pasi ka pasur mos respektim të ligjeve të Kosovës dhe nuk është marrë leje, duke shtuar që kjo ka qenë një qasje destruktive nga ana e disa qytetarëve serb. Tutje theksoi se është e rëndësishme që të pritet raporti për këtë ngjarje nga ana e institucioneve kompetente, për të parë nëse veprimet e ndërmarra kanë qenë proporcionale me nevojën.

**Muharrem Nitaj**, shprehi mospajtimi me deklaratimet e z.Mojsiloviq dhe z. Beqiri, duke theksuar që Komisioni që bëjnë pjesë është Komisioni profesional dhe nuk është vendi për të bërë komente politike për ngjarjen. Komisioni nuk posedon informacione, të cilat do të mund të tregonin se çfarë ka ndodhur dhe nëse Policia e Kosovës ka tejkaluar autorizimet, duke kërkuar që të përmbahen nga hapja e debatit, i cili nuk do ti ndihmonte asaj çfarë ka ndodhur, pasi duhet të pritet ekspertiza e institucioneve të ngarkuara me raportin e tyre dhe më pas të dilet me konstatime.

**Rexhep Selimi**, lidhur me vlerësimin e Komisionit si profesional, theksoi se përveç kësaj, Komisioni përfaqëson grupime politike dhe qëndrimet e tyre. Tutje theksoi se përcjell qëndrimin dhe mbështetjen e grupit parlamentar të Vetëvendosjes, që mbështet veprimet e ndërmarr për të mbrojtur rendin kushtetues të Kosovës, duke theksuar që zyrtari i lartë ka hyrë pa leje të institucioneve dhe është dashur të arrestohet. Po ashtu theksoi se nuk duhet ti gëzohemi përdorimit të forcës nga ana e zyrtarëve policor, po theksoi se në situatat e sigurisë kur kërkohet ndërhyrje të tilla duhet të bëhen. Lidhur me tubimin e organizuar nga ana e disa zyrtarëve serb në veri të vendit. Tutje kërkoi sqarim nga ana e z.Mojsiloviq. Kënd përfaqësoni ju si deputet në Kuvendin e Kosovës, Qeverinë e Kosovës apo atë të Beogradit?

**Muharrem Nitaj**, duke iu referuar diskutimeve, theksoi se u beson institucioneve të Kosovës që operacioni i realizuar në veri është kryer në përputhje me ligjin. Ndërsa sa i përket diskutimit për këtë temë, theksoi se si temë duhet trajtuar si e veçantë dhe jo tek të ndryshmet, duke shtuar që nga disa është përdorur për qëllime politike.

**Fatmir Xhelili**, duke iu referuar diskutimeve për temën e arrestimit të z.Gjuriq, theksoi se ai i ka shkelur ligjet e Kosovës, ndërsa është fakt që Policia e Kosovës ka vepruar sipas kompetencave ligjore të saj, për personat që hyjnë në territorin e Kosovës në rrugë jo ligjore. Ndërsa sa i përket konstatimit të z.Gjuriq, që operacioni është zhvilluar në baza etnike, nuk qëndron. Ndërsa s ai përket diskutimit për këtë çështje, theksoi se mund të bëhet por pasi të dërgohet raporti nga Policia e Kosovës lidhur me këtë ngjarje.

**Zoran Mojsiloviq**, lidhur me diskutimet në Komision, theksoi se është i vetëdijshëm që punojnë me sistemin e Kosovës dhe janë brenda këtij sistemi dhe ligjeve në fuqi dhe nuk është duke e keqpërdorur këtë pozicion. Për këtë arsye e ka potencuar që dhuna e përdorur ndaj ministrave, deputetëve dhe qytetarëve nuk ka qenë e pranishëm. Tutje theksoi se e tërheq nëse ka potencuar ndonjë gjë. Gjithashtu theksoi se nga policia është kërkuar z.Gjuriq, por pse me u rrah zyrtarët e tjerë nga policia, për këtë arsye theksoi se e kundërshton dhunën e përdorur nga Policia e Kosovës ndaj përfaqësuesve të veriut të Mitrovicës. Gjuriqi nuk ka folur diçka kundër Kosovës,

ndërsa është Presidenti Thaçi që takohen dhe flasin për integrimin në veri, dhe janë të njëjtat që i paraqesin në televizion, por kur është në nivel të Brukselit bisedojnë dhe diskutojnë. Nëse përfaqësuesit e politikës së komunitetit serb, nuk mund të mblidhen të diskutojnë për vizionin në Kosovë, për mënyrën se si dëshirojnë të jetojnë në Kosovë, atëherë nuk ka kuptim as ekzistenca. Tutje theksoi se në këtë takim ka shkuar me vonesë dhe nuk ka takim që ka prezantuar diçka, ndërsa ka qene Ministri i Bujqësisë që ka prezantuar. Komisioni për Siguri është për të mbrojtur këto aspekte dhe shtoi se kur do të jetë Ministri i MPB-së do të pyes për këtë çështje.

**Fatmir Xhelili**, theksoi se e vlerëson që z.Mojsiloviq e tërhoqi qëndrimin që operacioni është bërë në baza etnike, ndërsa theksoi se si grupo, politik kanë të drejtë të takohen, por hyrja e zyrtarëve të shtetit serb pa lejen e autoriteteve të Kosovës nuk është e lejueshme. Ndërsa s ai përket qëndrimin të z.Mojsiloviq ë të interesohet për këtë ngjarje është e drejtë e tij.

**Xhelal Sveçla**, duke iu referuar zhvillimeve të fundi, theksoi se po vërtetohet fakti që Kosova jeton në një situatë paradoksale, ku në njërin anë të njëjtit njerëz janë pjesë të institucioneve dhe në anën tjetër luftojnë shtetëformimin e të njëjtit shtete. Fjala është për Listën Serbe, e cila është instrument i hegjemonisë së Serbisë në Kosovë dhe kjo gjë nuk mohohet nga ta, ku përfundon në një aktivitet ilegal të dy përfaqësuesve të një shteti tjetër, ku marrin pjesë deputet, ministra të shtetit të Kosovës. Gjithashtu theksoi përveç që nuk mungonte gjuha shoviniste gjatë takimit, në të merr pjese edhe Komandanti i Policisë së Veriut. Tutje theksoi se nuk dinë ndonjë rast që, një shtet sovran që lejon ndonjë grup që të minoj sovranitetin e tij, duke shtuar që është e rëndësishme që përfaqësuesit e komunitetit serb të deklarohen se interesat e kujt i përfaqësojnë. Po ashtu vlerësoi që javën e ardhshme, të ftohet Ministri i Punëve të Brendshme të raportoj për këtë ngjarje dhe për zhvillimet gjatë gjithë ditës.

**Zoran Mojsiloviq**, theksoi se kërkon falje që ka dalë jashtë rendit të ditës, por pas komenteve të marra deklaroi që Lista Serbe është parti politike që kanë pranuar integrimin në sistemin e Kosovës dhe të bashkëjetesës por jo përjetimin e ndonjë dukurie siç do të ishte asimilimi i komunitetit serb. Duke iu referuar fjalës së z.Sveçla që z.Gjuriq ka hyrë në Kosovë një ditë më herët, theksoi se nuk ka informacion nëse ka ndodhur kjo

**Xhelal Sveçla**, theksoi se problematike është mungesa e informatave, pasi në disa media është raportuar që z.Gjurigj ka hyrë në territorin e Kosovës një ditë më parë, duke shtuar që ka shumë çështje për të cilat duhet marrë përgjigjeje. Ndërsa sa i përket asimilimit, theksoi që nuk bëhet fjalë për këtë gjë, por për minimin e shtetit të Kosovës nga ana e disa grupimeve.

**Kryetari**, lidhur me propozimin për të ftuar Ministrin e Punëve të Brendshme, theksoi që fillimisht se pasi të dërgohet një raport zyrtar për këtë çështje nga ana e Policisë së Kosovës dhe më pas të ftohet Ministri. Gjithashtu propozoi që gjatë kësaj jave të realizohet një vizitë pune në Aeroportin e Prishtinës.

Me këtë pikë të rendit të ditës e konsideroi mbledhjen e mbyllur.

Mbledhja përfundoi në orën 12:00.

**E përgatiti:**  
**Stafi mbështetës i komisionit.**

**Kryetari i komisionit,**

---

**Haxhi Shala**